



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER AIDA A. HOXHA
ADRESA MINE PEZA, NR.83/1
TEL: 689090075**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Nr. repertori: 2455

Tirane më 29/05/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2025051010167897792



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“HOTELS EQUIPMENT” SH.P.K

Sot, me datë 29.05. 2025, unë e nënshkruara:

Marta Wieczorek, e bija e Dariusz dhe Anna, e datëlindjes 20.02.1990, lindur në Varshave dhe banuese në rr. Mickiewicza 17, kodi postar 05-074, Halinow, Poloni, mbajtëse e pasaportës me numer personal EK4740155, shtetase polake, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008. "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“Hotels Equipment” sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

**Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë**

Emri i Shoqërisë është **“Hotels Equipment” sh.p.k.**

**Neni 2
Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë është në: Lagja Nr.2, rruga “Jurgen Trade”, Pasuria Nr. 1/230, Ndertesa Nr. 1, Zona Kadastrale 8551, Kavaje, Shqipëri.

**Neni 3
Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhe të pacaktuar


**Neni 4
Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka për objekt të aktivitetit të saj kryesisht:

- Blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë të pajisjeve për hotelieri

Wieczorek
[Signature]

Është i përfshirë në objektin e Shoqërisë kryerja e çdo veprimtarie tjetër e ngjashme, e lidhur, e domosdoshme apo sidoqoftë e dobishme për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme që mund t'i kryejë për llogari të saj apo për të tretë si dhe çdo veprimtari tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.



Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqërisë

Kapitali fillestar i Shoqërisë është **100.000 lekë** (njëqindmijë lekë) dhe përbehet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqindmijë) lekë kuota që i përkasin ortakut të vetëm të Shoqërisë **znj. Marta Wiczorek**.

Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm nga ortakut i vetëm i Shoqërisë.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga ortakut i vetëm i Shoqërisë dhe organet e saj të cilat janë si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm
2. Administratori

Kompetencat, mënyra e thirrjes dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të Vetëm janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë emërohet për një afat kohor të pacaktuar Administrator i Shoqërisë është **znj. Marta Wiczorek**.

Neni 7

Të Drejtat dhe Detyrat e Shoqërisë

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të sigurojë pasurinë e saj;
3. të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
4. të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
5. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;

Wiczorek
[Signature]

- 
6. të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;
 7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 8

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e Shoqërisë në formën dhe në kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen Shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 9

Marrëdhëniet Ekonomiko-Financiare të Shoqërisë

E gjithë veprimtaria e Shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

Neni 10

Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

Neni 11

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqëria mban xhiro-llogaritë në Bankë. Llogaritë mbahen në lekë dhe në çdo valutë të huaj të cilat pasqyrohen në librat përkatëse.

Neni 13

Vula dhe Logo

Shoqëria ka vulën dhe logon e vet dalluese.

Wicoreh
per.

Neni 14
Shndërrimi Mbarimi Likujdimi i Shoqërisë

Mënyra dhe format e Shndërrimit, Mbarimit dhe Likujdimit të Shoqërisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë



Neni 15

Dispozita të Përgjithshme

Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë akt themelimi, do ti referohet statutit të Shoqërisë, legjislacionit shqiptar si edhe ndryshimeve të mëvonshme që do të kryen nga Asambleja e Përgjithshme e ortakut të vetëm sipas ligjit në fuqi.

Neni 16

Akti i Themelimit është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë identikë, në gjuhën shqipe me asistimin e përkthyeses së licesuar të gjuhës polake znj. Jorida Alliu, të gjitha origjinale të nënshkruara rregullisht nga themeluesi dhe ortakut i vetëm.

THEMELUESI DHE ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

“HOTELS EQUIPMENT” SH.P.K.

Marta WIECZOREK

Marta Wieczorek
Wieczorek

